



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI**

**U R D H Ë R**

**Nr. 135, datë 13.09.2018**

**PËR**

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR  
ZBATIMIN E MASËS 64 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË  
KOMBËTARE PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit".

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 64 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:

- ministri përgjegjës për diasporën		kryetar;
- zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme		anëtar;
- zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin		anëtar;
- zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për financat		anëtar;
- titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën		anëtar.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të kryejë vlerësimin për numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit, për fushat ku ata specializohen dhe të konsiderojë përfshirjen e



kushtit të kthimit në Shqipëri për studentët të cilët marrin bursa studimi për jashtë vendit si dhe organizimin e informacionit e të mundësive për punësimin e tyre në vendlindje.

4. Grupi ndërinstytucional i punës të mbledhet çdo 3 (tre) muaj dhe të raportojë me shkrim në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën.
5. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**